

27 qershor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Deurbanizimi i Qendrës Historike të Prizrenit

Edhe gjatë muajit qershor ka vazhduar monitorimi i punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe në fokus të monitorimit kanë qenë sektori i urbanizmit dhe ai i kulturës.

EC Ma Ndryshe shpreh shqetësim me gjendjen e krijuar në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor në qytetin e Prizrenit ku rreth 80% të ndërtimeve nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit. Për më tepër, tendencat për pazarllëqe të ndryshme me kompanitë ndërtimore janë fenomeni dominues i projekteve urbanistike të financuara nga buxheti i komunës së Prizrenit. EC Ma Ndryshe kërkon nga Kryetari Ramadan Muja që të iniciohen procedurat për rrënimin e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe atyre që janë bërë jashtë kriterëve të ndërtimit, sidomos në Qendrën Historike të Prizrenit. Në vazhdim të monitorimit, shumë shpejtë do të dalim edhe me rastet konkrete në ato ndërtime që nuk janë përfillë kriteret urbanistike.

Dëshmia më e mirë për degradimin urbanistik të Prizrenit është shkresa zyrtare me Nr. 04-353 e Drejtorisë së Urbanizmit drejtuar Drejtorisë së Inspektoratit, në të cilin, në mes tjerash thuhet se “në bazë të evidencës që posedon shërbimi i DUPH ju njoftojmë se ndërtimet të cilat janë duke u zhvilluar kohëve të fundit janë mjaft shqetësuese; ato të cilat kanë leje ndërtimi mbi 80% nuk i janë përmbajtur lejes së ndërtimit ndërsa një numër shumë i madh i ndërtimeve tjera janë pa kurrfarë leje të ndërtimit. Shërbimi i DUPH-së është i shqetësuar sidomos në lokacionet për të cilat disponon me plane rregulluese (Prevallë, Jani Mëhallë, Lakuriqi, Dardania etj) ndërsa në brendinë e tyre ndërtohet duke mos ju përmbajtur planeve rregulluese”.

Një nga dokumentet që dëshmojnë paradokset në sektorin e urbanizmit në Prizren është kërkesa e NNTSH “Drini Company”, e cila në emër të kompensimit për punimet e kryera me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Drejtorinë e Urbanizmit ka kërkuar t’i jepet leja ndërtimore. Këto fakte dokumentohen në shkresën zyrtare me numër 04-353 të datës 18.04.201; drejtuar Kryetarit të Komunës së Prizrenit nga Drejtoria e Urbanizmit.

Në takimin me përfaqësues të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, monitoruesit kanë evidentuar disa të meta në punën e këtij sektori. Buxheti total për tre sektorët e kësaj drejtorie për vitin 2012 në kategorinë e subvencioneve është 115 mijë euro; ku deri më tani janë shpenzuar 59 mijë e 150 euro, ndërsa në këtë kategori nga buxheti i këtij viti janë paguar 30 mijë euro burgje nga kategoria e subvencioneve. Një nga të metat kryesore të sektorit të kulturës në Prizren është mungesa e Strategjisë për Zhvillimin e Kulturës. Për më shumë, qeveria lokale e Prizrenit nuk ka planifikim dhe hartim adekuat të politikave kulturore, ndërsa buxheti për sektorin e kulturës hartohet pa konsultim me komunitetin artistik dhe kulturor të qytetit.

EC Ma Ndryshe i rekomandon fuqishëm qeverisë lokale që sa më parë të hartojë Strategjinë për Kulturën dhe të hyjë në dilog të strukturuar me shoqërinë civile për hartimin e politikave adekuate kulturore.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit korrik përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të

gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në web-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +386 49 116 448